



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/153
Datë: 21.08.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 49 të Ligjit për Protokollin e Shtetit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i veçantë për organizimin e ceremonisë mortore shtetërore për ish Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Bajram Rexhepi.
2. Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi funksionon nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 2.1. Z. Hajredin Kuçi, Zëvendëskryeministër, Kryesues;
 - 2.2. Znj. Vlora Dumoshi, Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 2.3. Z. Haki Demolli, Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
 - 2.4. Z. Skënder Hyseni, Ministër i Punëve të Brendshme;
 - 2.5. Z. Arsim Bajrami, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 2.6. Z. Sokol Havolli, Shef i Kabinetit të Kryeministrit;
 - 2.7. Përfaqësues i Familjes Rexhepi;
 - 2.8. Z. Agim Bahtiri, Kryetar i Komunës së Mitrovicës;
 - 2.9. Protokolli i Shtetit.
3. Kryesuesi mund të caktojë edhe anëtarë të tjerë të Komisionit të veçantë.
4. Shpenzimet e varrimit do të mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë